



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GRACANICA

Numri i lëndës: 2019:218840

Datë: 19.07.2021

Numri i dokumentit: 02010745

P.nr 102/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË / DEGA NË GRAQANICË / DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rrustem Begolli, me sekretarin juridik Fatmir Gashi, në çështjen penale, kundër të pandehurve N.Ndhe I.M, për shkak se në bash kryerje kanë kryer veprën penale Legalizimi i përmbajtjes së pa vërtet nga neni 334 par.1 të KPK-së lidhur me nenin 23 të KPK, dhe veprën penale Shmangie nga pagesat e obligimeve doganore nga neni 318 par.1 lidhur me nenin 23 të KPRK-së po ashtu në bash kryerje, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.110/17, të datës .30.05.2018, në seancën e dytë fillestare të mbajtur me dt.14.06.2021, në praninë e prokurorit të shtetit Remzush Latifi të pandehurve N.Ndhe I.M, në bazë të nenit 366 të KPP të Republikës së Kosovës, me datë 14.06.2021 mori dhe në prezencën e palëve publikisht shpalli , dhe përpiloi me datë 09.07.2021 këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. I pandehuri: N.N**nga i ati .. e ëma ..e gjinisë ..., i lindur me .. në .. , me vendbanim në .., i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal .., ka të kryer shkollën e mesme , Sërb shtetas i Republikës së Kosovës.
- 2. I pandehuri: I.M** nga i ati .. dhe e ëma .. e gjinisë .. i lindur me .. në V.. , me vendbanim në rrugën .., i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal , ka të kryer shkollën e mesme , Sërb shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

Sepse:

Të pandehurit me datë 20.02.2012, me qëllim dhe dashje të shmangies së pagesës së obligimeve doganore, në bashkëpunim me njeri tjetrin, falsifikojnë librezën e qarkullimit nr.CP08591493, e cila të jetë në emër të pandehurit N ër veturën e tipit VW Golf 1.9 TDI, ngjyrë e hirit metalike, viti i prodhimit 2001 me numër të shasisë WVWZZZ1Z2P274712 e më pas drejtohet në QRAK në Graqanicë, të njëjtën e vënë në lajthim për ta vërtetuar këtë çështje të pa vërtet, ashtu që ky dokument i falsifikuar mirët si i vërtet me qëllim të regjistrimit të automjetit të njëjtë, fakt ky që zbulohet pas analizës që bëhet kësaj libreze nga laborator i kriminalistikës, e si rezultat i kësaj me datë 02.03.2015 Dogana e Kosovës sekuestron automjetin, e tërë të pandehurit e bëjnë për

përfitim të jashtë ligjshëm dhe njëkohësisht dëmtojnë buxhetin e Republikës së Kosovës në vlerë të përgjithshme prej 1.450 euro.

-Me këtë në bash kryerje kanë kryer veprën penale Legalizimi i përmbajtjes së pa vërtet nga neni 334 par.1 të KPK-së lidhur me nenin 23 të KPK-së

Andaj gjykata në bazë të nenit të lartë cekur dhe nenit 4, 7, 17, 41, 42, 43, 45,46,47, si dhe nenit 73 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPRK-së, të akuzuarit N.Ndhe I.M :

E GJYKON

Dënim me burg në kohëzgjatje prej **3 (tre) muaj**, i cili dënim konform nenit 47 dhe nenit 46 ë KPRK-së, do ti zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej **400 € euro**.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund te realizohet as me detyrim, gjykata këtë dënim me gjobë do ta zëvendësoj me dënimin e shqiptuar me burg si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Obligohen të pandehurit që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej nga **20 € për secilin** në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, si dhe shpenzimet tjera procedurale në bazë të fletë shpenzimit të gjykatës.

2 HEDHET Akuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.110/17, të datës 30.05.2018, dhe Pushohet procedura penale kundër të pandehurve: N.Ndhe I.M **për pikën e dytë të aktakuzës, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale**

Shpenzimet e procedurës penale, bien barrë e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.110/17, të datës 30.05.2018e ka akuzuar të pandehurin N.Ndhe I.M, për shkak se në bash kryerje kanë kryer veprën penale Legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 par.1 të KPK-së lidhur me nenin 23 të KPK, dhe veprën penale Shmangie nga pagesat e obligimeve doganore nga neni 318 par.1 lidhur me nenin 23 të KPRK-së po ashtu në bash kryerje.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seanca e të fundit me datë 14.07.2021, gjatë së cilës seancë u dëgjuan Prokurori i shtetit dhe të pandehurit N.Ndhe I.M.

Në seancën e shqyrtimit të dytë fillestar datës 14.06.2021 të pandehurit N.Ndhe I.M, kanë deklaruar se e ka kuptuar dispozitivin e aktakuzës dhe ndjehet fajtorë për kryerjen e veprës penale për të cilën janë akuzuar nga Prokuroria e Shtetit, dhe ju vjen keq për rastin që ka ndodhur.

Prokurori i shtetit Remzush Latifi, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri deklaroi se, me qenë se të pandehurit e pranojnë fajësinë në përputhje me dispozitat e nenit 248 te KPP-së dhe njëherë pranimi i fajësisë është me përputhje të plotë me provat të cilat i janë bashkangjitur aktakuzës pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve.

Nga pranimi i fajësisë në mënyrë të plotë dhe të vullnetshme nga të pandehurit gjykata në bazë të nenit 248 par.4 të KPP të RK-së, në seancën e shqyrtimit të dytë fillestar, me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga të pandehurit pasi që është bindur plotësisht se të pandehurit ishin të vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë dhe se të pandehurit e kanë pranuar fajësinë pa presion dhe me vullnetin e tyre të plotë.

Nga faktet e vërtetuara nga shkresat e lëndës, nga deklaratimet e palëve në procedurë dhe nga vet pranimi i fajësisë nga të pandehurit, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve N.Ndhe I.M ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale si në hyrje të këtij aktgjykimi, si dhe vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtor të njëjtin pasi që më parë gjeti se penalisht janë përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që ndaj të pandehurit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese se i pandehuri ishte e sigurtë gjatë shqyrtimit gjyqësor, se e ka pranuar fajësinë, pendimin e tij, se është mbajtës i familjes, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti dhe për këtë shakë për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 50 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi sa i përket të pandehurve N.Ndhe I.M është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73.par.2, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Gjyqtari i çështjes me datë 13.07.2020 është ngarkuar me këtë lëndë.

Pas shqyrtimit të lëndës, është konstatuar se në mbështetje të dispozitave nga neni 106 dhe 107 të Kodit Penal të Republikës Kosovës, ndalohet ndjekja e mëtutjeshme penale ndaj të pandehurit M.J, pasi që kanë kaluar afatet e caktuara ligjore nga koha e kryerjes së veprave penale, pasi që kemi të bëjmë me parashkrim, çka në rastin konkret për shkak të veprës penale veprën penale Shmangie nga pagesat e obligimeve doganore nga neni 318 par.1 lidhur me nenin 23 të KPRK-së në bash kryerje, nuk mund të ndërmerret ndjekja penale pasi që kanë kaluar afatet ligjore për ndërmarrjen e veprimeve dhe se dënimi për veprën penale në fjalë, është se kryerësi dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 (tre), vjet, kurse në bazë të nenit 106 par.1 të KPRK-së, “ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar afatet si më poshtë”, ku sipas nën par. 1.5 i po këtij neni është “tre vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme më shumë se një 1 vit burgim”, që nënkupton se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret pasi që kanë kaluar mbi 3 vite, ndërsa sipas nenit 107 par. 8 të KPRK-së “ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale), andaj në lidhje me kohën e dyshimit të kryerjes së kësaj veprë penale me datë 20.02.2012, e lidhur me nenin 106 par.1 nën par. 1.5 e lidhur me nenin 107 par. 8 të KPRK-së, në këtë rast penal kemi parashkrim absolut të ndjekjes penale. Parashkrimi absolut në këtë rast penal ka arritur me datën 20.02.2018, pasi që brenda kësaj periudhe kohore, nuk ka përfunduar ndjekja penale.

Gjykata pasi ka vërtetuar se në këtë çështje penale ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale sa i përket veprës penale Shmangie nga pagesat e obligimeve doganore nga neni 318

par.1 lidhur me nenin 23 të KPRK-së po ashtu në bash kryerje , duke vlerësuar se parashkrimi është një rrethanë e cila e pengon ndjekjen e mëtejme penale ndërsa mbi bazën e këtyre arsyeve vendosi qe të hedhë akuzën dhe të pushoje procedurën penale ndaj të akuzuarit N.Ndhe I.M.

Andaj gjykata duke u bazuar ne nenin 358 par. 1 nenpar.1.3 të KPPRK-së, e Hudhi akuzën dhe e pushoj procedurën e mëtutjeshme penale ndaj të akuzuarit N.N dhe I.Mi dhe atë duke u bazuar në nenin 106 par.1 nën par. 1.5, e lidhur me nenin 107 par. 8 te Kodit Penal te Kosovës.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pikat 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË / DEGA NË GRAQANICË /
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.102/2020, dt. 09.07.2021.**

Sekretari juridik
Fatmir Gashi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Rrustem Begolli

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.